



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 55 Akti**

**Nr. 39 Vendimi**  
**Tiranë më 17.07.2018**

**V E N D I M**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me anë të trupës gjyquese të përbërë nga:

<b>1. Brunilda</b>	<b>BEKTESHI</b>	<b>Kryesues</b>
<b>2. Roland</b>	<b>ILIA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>3. Firdes</b>	<b>SHULI</b>	<b>Relatore</b>

me sekretare gjyqësore znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, më datat 13.07.2018, ora 15.00 dhe 17.07.2018, ora 12.30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKT I RIVLERËSIMIT:** **Z. Tom Ndreca**, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.

**OBJEKTI :** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE :** Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të **Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** të ndryshuar me ligjin nr. nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligj nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Firdes Shuli, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Tom Ndreca, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V E R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit z. Tom Ndreca, në periudhën dhjetor 1991 - prill 1994, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Mirditë. Në periudhën prill 1994- 26.04.2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga muaji prill 2013 e deri më sot ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë Tiranë. Duke qenë se ai është anëtar i Gjykatës së Lartë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, sipas nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

2. Neni 179/b, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

3. Bazuar në nenin 14 pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si Komisioni), ka hedhur shortin në datën 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Tom Ndreca, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues me nr. 01, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes, u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Me vendimin nr. 29 datë 23.05.2018, Komisioni ka vendosur që për arsye objektive komisionere Alma Faskaj, e caktuar si kryesuese e trupës, të zëvendësohet nga komisionere Brunilda Bektashi.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën me nr. 638/27 datë 17.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të

identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, ky instituciuon ka dërguar një raport me shkresën nr. 12108 prot., datë 02.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

6. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. 3118/2 prot., datë 12.01.2018.

7. Menjëherë me hedhjen e shortit, trupi gjykues nr. 01, administroi:

- raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar si “ILDKPKI”),
- raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 -39 të ligjit nr. 84/2016 të hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”),
- raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar si “KLD”).

8. Me vendimin nr. 01 datë 06.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Tom Ndreca, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupës, komisioneren znj. Alma Faskaj (zëvendësuar nga komisionere Brunilda Bekteshi). Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 02, datë 22.06.2018, trupi gjykues, vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë dhe figurës së subjektit të rivlerësimit z. Tom Ndreca.
- T’i njoftojë subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara për këto dy kritere, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45-47 dhe 35-40 të K.Pr.A-së;
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

10. Në datën 08.07.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit, parashtrësë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

11. Me vendimin nr. 03 datë 10.07.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.07.2018 ora 15.00, pranë Pallatit të Koncerteve (ish Pallati Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca, bazuar në dy komponentë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës.

## **II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË.**

### **II.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI.**

Në përputhje me nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI ka dërguar raport të hollësishëm<sup>1</sup> dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara prej 415 fletësh.

Nga aktet e ILDKPKI-së, rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 deri në vitin 2016. Në datën 30.01.2017 sipas ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për vetting pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* si dhe ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndyshuar.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë, ILDKPKI ka konstatuar se:

- deklarimi i subjektit është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

<sup>1</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 17.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

## II.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit Tom Ndreca, nga ana e Komisionit, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të Kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore, të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- a. verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
  - b. verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
  - c. evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
  - ç. evidentimin ose jo deklaratimeve të rreme;
  - d. nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit;
- me qëllim evidentimin e faktit, nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### Hetimi administrativ për pasuritë në rend kronologjik sipas viteve:

Vitet 1994-2003:

1. Subjekti ka deklaruar në deklaratën për vetting apartament banimi me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, adresa: Rruga "\*\*\*", pll. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\* Tiranë, blerë përkatësisht sipas kontratës me nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., datë 05.04.2003 në çmimin e shitjes 2.400.000 lekë, dhe kontratës së shitjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., datë 14.04.2003 në çmimin e shitjes 468.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit:

- a. Të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes ndër vite, shitja e një apartamenti në Rrëshen, (përfutur nga privatizimi në bazë të ligjit nr. 752/1992) në vlerën 550.000 lekë dhe nga ndihma dhe huatë e dhëna nga vëllezërit dhe motrat emigrantë në Greqi (nga 200.000 lekë secili).

b. Edhe pse blerja e garazhit është realizuar me kontratë të veçantë noteriale nga ajo e blerjes së apartamentit, subjekti ka deklaruar se shitja e tij është ofruar pa pagesë nga ndërtuesi në ekuivalencë të detyrimeve të krijuara, si rezultat i shumë punimeve të kryera privatisht nga ana e tij në banesë. (devijim i projektit fillestar).

Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, pasuria me numër fillestar \*\*\*, (sot pasuria me nr. \*\*\*) blerë në vitin 2003,

Komisioni ka konstatuar se:

- ZVRPP Tiranë<sup>2</sup>, konfirmon se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij si pasuria me nr. \*\*\*.
- Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e vitit 2003, ku faktikisht bëhet fjalë:

a. Për një apartament banimi 2+1 në Rr. “\*\*\*”, pll. 21/1, ap. 11, duke përcaktuar si çmim shitje çmimin 3.000.000 lekë.

b. Për apartament 2+1, me çmim blerje 2.400.000 lekë, me të njëjtën adresë.

Është pyetur subjekti<sup>3</sup>, lidhur me faktin përse janë deklaruar dy pasuri në të njëjtën adresë, dhe ai është përgjigjur<sup>4</sup> se nuk ka pasur dhe nuk ka apartament banimi sipas pikës “a” si më sipër.

Lidhur me faktin se në deklaratimet për vitin 2003 rezultojnë dy apartamente banimi, nga verifikimi pranë ZVRPP-së, nga deklaratimet e subjektit dhe nga fakti se në deklaratimin për vitin 2003, deklarohen dy pasuri me të njëjtën adresë, Komisioni vlerëson se në deklaratimin për vitin 2003 bëhet fjalë për të njëjtën pasuri të përbërë nga apartamenti prej 120 m<sup>2</sup>, sot pasuria nr. \*\*\*, dhe garazhi me sip. 18 m<sup>2</sup>, sot pasuria nr. \*\*\*, pasuri që më parë kishin të dyja numrin \*\*\*. Pra subjekti nuk ka pasur dy pasuri, por **deklarimi i dy pasurive në deklaratën e vitit 2003, është pasaktësi e tij gjatë plotësimit të formularit të deklaratimit për këtë vit.**

- Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vetting si pasuria me nr. \*\*\*, apartament banimi 120 m<sup>2</sup>, me burim të ardhurash:

a. Pjesërisht nga pagat.

b. Shuma prej 550.000 lekësh të përfituara nga shitja e apartamentit në Rrëshen me kontratën nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 12.01.1998. Në deklaratën e vitit 2003, kjo shumë është deklaruar 800.000 lekë, ndërkohë që çmimi i shitjes së kësaj pasurie është 550.000 lekë. **Siç rezulton, ka mospërputhje midis deklaratës për vetting dhe deklaratës së vitit 2003, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.**

<sup>2</sup> Shih shkresën nr. \*\*\*prot., datë 29.12.2017, në dosjen e KPK-së.

<sup>3</sup> Shih pyetjet për subjektin të datës 06.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>4</sup> Shih përgjigjet e subjektit të datës 12.02.2018, në dosjen e KPK-së.

Është pyetur subjekti për këtë mospërputhje, dhe ai shpjegon<sup>5</sup>, *se apartamenti në Rrëshen është shitur në shumën 800.000 lekë. Shuma prej 250.000 lekë është çmimi i shitjes së orendive, por nuk ka dokument për ta vertetuar këtë.*

Konstatohet se as në deklarinimin për vitin 2003, dhe as në deklaratën për vetting subjekti i rivlerësimit nuk e ka përmendur faktin se shuma prej 250.000 lekësh, është përfituar nga shitja e orendive shtëpiake të banesës në Rrëshen, ndërkohë që, nuk u administrua asnjë dokument për vërtetimin e këtij fakti. Për këto arsye, gjatë analizës financiare, si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> në Tiranë, pasuria me nr. **\*\*\***, është marrë në konsideratë shuma prej 550.000 lekësh<sup>6</sup>, e deklaruar në deklaratën për vetting, dhe jo shuma prej 800.000 lekësh, e deklaruar në deklarinimin për vitin 2003.

c. Shuma prej 800.000 lekësh të dhëna si ndihmë nga motrat dhe vëllezërit, për të cilat subjekti deklaroi se **nuk ka dokument që të vërtetojë dhënien dhe shlyerjen e huave**. Në deklaratën për vitin 2003, kjo shumë është deklaruar 900.000 lekë. **Ka mospërputhje të deklaratës për vetting me deklarinimin për vitin 2003, lidhur me shumën e marra hua**. Subjekti këtë e shpjegon se *ka deklaruar me aq sa mban mend*<sup>7</sup>.

Duke marrë në konsideratë faktin se shumën e dhëna hua kanë qënë relativisht të vogla, periudha e dhënies se huave është e hershme (mundësia për të vërtetuar burimin e krijimit nga huadhënësit të cilët siç deklarohet kanë qënë emigrantë, është e vogël), si dhe faktin se marrja e dhënies e huave mes familjarëve praktikisht është bërë shpesh pa dokument shkresor, Komisioni e ka përfshirë në analizën financiare shumën e huave prej 800.000 lekësh, duke e konsideruar si burim të ardhurash për blerjen e pasurisë nr. **\*\*\***, apartament banimi me sip. 120 m<sup>2</sup> <sup>8</sup>.

Persa i përket likuidimit të çmimit të shitjes së apartamentit, shoqëria **“\*\*\*” sh.p.k.**,<sup>9</sup> ka vënë në dispozicion tre mandat-arkëtime të viteve 1997 dhe 1998, me të cilat konfirmohet pagimi i çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, në shumën prej 2.400.000 lekësh.

Lidhur me garazhin me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>, pasuria me numër fillestar **\*\*\***, (sot pasuria me nr. **\*\*\***), blerë në vitin 2003,

Komisioni ka konstatuar se:

- ZVRPP Tiranë<sup>10</sup>, konfirmon se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.
- Në deklarinimin për vitin 2003, nuk deklarohet kjo pasuri. **Deklarimi për vitin 2003, ka qënë i pasaktë, pasi nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarinimin e kësaj**

<sup>5</sup> Shih deklarinimet e subjektit të datës 12.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>6</sup> Shih analizën financiare për periudhën 1994-2003, tabela 1 e këtij vendimi.

<sup>7</sup> Shih deklarinimet e subjektit në përgjigjet e datës 06.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>8</sup> Shih analizën financiare për periudhën 1994-2003, tabela 1 e këtij vendimi.

<sup>9</sup> Shih shkresën nr. **\*\*\*** prot., datë 07.02.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>10</sup> Shih shkresën e ZVRPP nr. **\*\*\*** prot., datë 29.12.2017, në dosjen e KPK-së.

**pasurie.** (ligji nr. 9049/10.04.2003). Është pyetur subjekti<sup>11</sup>, dhe ka pranuar se *nuk është deklaruar kjo pasuri në vitin 2003, për mungesë vëmendjeje.*

- Është deklaruar në deklaratën për vetting, dhe në rubrikën “burim të ardhurash”, se për garazhin nuk ka paguar vlerë financiare për shkak të dakortësisë me firmën ndërtuese në ekuivalencë të punimeve të kryera prej tij. Është pyetur subjekti, nëse ka dokument që të vërtetojë pretendimin si më sipër, dhe ai konfirmon se nuk ka dokumente vërtetuese<sup>12</sup>. Po kështu, është pyetur shoqëria “\*\*\*” sh.p.k,<sup>13</sup> e cila gjithashtu nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë vlerën e punimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në ekuivalencë të çmimit të shitjes së garazhit. Nuk ka asnjë provë që të vërtetojë ndonjë marrëveshje midis palëve për mospagimin e çmimit të shitjes së garazhit.

Ky deklaram i subjektit në deklaratën për vetting, bie në kundërshtim me kontratën e blerjes së garazhit<sup>14</sup>, e cila konfirmon pagesën e çmimit të shitjes prej 468.000 lekësh, jashtë zyrës noteriale. Sa më sipër, lidhur me burimin e krijimit të garazhit subjekti i rivlerësimit ka:

- ✓ **Mospërputhje deklarimesh në deklaratën për vetting me kontratën e shitjes.**
- ✓ **Deklarime të rreme në deklaratën për vetting,** lidhur me pagimin e çmimit të shitjes së garazhit, për shkak se këto deklarime vijnë në kundërshtim me kontratën e shitjes së garazhit me nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 14.04.2003, në çmimin e shitjes 468.000 lekë, dhe rezultojnë të jenë të pavërteta. (neni 33 pika 5 germa “ç” i ligjit nr. 84/2016).

Vlera e garazhit prej 468.000 lekësh e vërtetuar me kontratën e shitjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., datë 14.04.2003, është llogaritur si shpenzim për blerjen e pasurisë gjatë analizës financiare<sup>15</sup>. (Apartament banimi dhe garazh në Rr. “\*\*\*” në çmimin 2.868.000 lekë). Ndërkohë, konstatohet se **deklarimi i çmimit të blerjes së pasurisë (apartament + garazh) në vitin 2003, është i pasaktë,** për shkak se vlera totale e apartamentit + garazhit nuk është 3.000.000 lekë sa është deklaruar, por 2.868.000 lekë. Lidhur me këtë pasaktësi, subjekti ka sqaruar se ka një gabim njerëzor në llogaritje nga ana e tij.

2. Në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar një makinë tip Benz me vlerë 300.000 lekë. Më pas nuk ka deklarim nga subjekti për këtë mjet.

#### Analizë financiare për periudhën 1994-2003:

Duke qenë se të dhënat për të ardhurat e subjektit fillojnë në vitin 1994 dhe pasuria e parë rezulton të jetë vënë në vitin 2003, gjatë hetimit administrativ është kryer analizë financiare për këtë

<sup>11</sup> Shih përgjigjet e datës 06.02.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>12</sup> Shih përgjigjet e subjektit të datës 12.02.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>13</sup> Shih shkresën e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., nr. \*\*\* prot., datë 27.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>14</sup> Shih kontratën e shitjes nr. \*\*\* datë 14.04.2003, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>15</sup> Shih analizën financiare për periudhën 1994-2003, tabela 1 e këtij vendimi.



periudhë, në përfundim të së cilës rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe likuiditetet në vitin 2003. Kjo analizë është përmbledhur në tabelën më poshtë:

<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>1994- 2003</b>
<b>PASURI</b>	<b>4.318.000</b>
makinë tip Benz	300.000
Apartament banimi dhe garazh në Rr. “***”	2.868.000
Arredim i apartamentit të mësipërm	1.700.000
Shitje apartamenti në Rrëshen	-550.000
<b>Detyrimet</b>	<b>800.000</b>
Prena Ndreca	400.000
Lek Ndreca	200.000
Vera Ndreca	200.000
Besnik Ndreca	100.000
<b>PASURI NETO</b>	<b>3.518.000</b>

<b>SHPENZIME</b>	<b>2.502.252</b>
Shpenzime jetese	2.502.252
<b>Të ardhurat e dokumentuara</b>	<b>6.162.287</b>
paga subjekti 2003	753.816
paga BSH 2003	298.413
Të ardhura të tjera 1994-2002	5.110.058
<b>DIFERENCA PËR SHPENZIME TË TJERA</b>	<b>142.035</b>

Tabela 1

Vitet 2004 dhe 2005:

Gjatë këtyre viteve subjekti nuk ka deklaruar pasuri.

Gjatë hetimit administrativ, është vërtetuar se djali i subjektit të rivlerësimit, z. E. N., ka blerë një autoveturë në vitin 2005, por nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklarin periodik për këtë vit. Me kërkesë të Komisionit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor<sup>16</sup> ka konfirmuar se Erion Ndreca, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*12.08.2005, ka blerë një automjet të markës MERCEDES BENZ, regjistruar për herë të parë në emër të tij në vitin 2005, me targë \*\*\*, në çmimin e blerjes 250.000 lekë. Rezulton që ky mjet është shitur në vitin 2014 me kontratën e shitjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., datë 13.10.2014 në vlerën 200.000 lekë.

<sup>16</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 27.02.2018, në dosjen e KPK-së.

**Deklarimi për vitin 2005, ka qenë i pasaktë, pasi nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarimin e kësaj pasurie.** (ligji nr. 9049/10.04.2003). Ndërkohë, nga analiza financiare për vitet 2004-2005, përmbledhur në tabelën më poshtë, vërtetohet se **subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe likuiditetet në shumën 1.140.165 lekë.**

		2004	2005
1	TË ARDHURA	1,377,778	1.378.314
	të ardhura nga paga subjekti	1,044,000	1.024.183
	të ardhura nga paga bashkëshortja	333,778	354.131
2	SHPENZIME	1,432,308	1.513.949
	shpenzime jetese	922,044	922.044
	shpenzime udhëtimi	110,264	91.905
	shlyerje detyrimi	400,000	500.000
3	PASURI	250,000	700.000
	Makinë		250.000
	Kursime	250,000	450.000
	Diferenca (1-2-3)	-304,530	-835.635

Tabela 2

Vitet 2006, 2007, 2008:

Subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk është vërtetuar të ketë blerë pasuri.

Gjatë hetimit administrativ, në përfundim të analizës financiare, pasqyruar si në tabelën më poshtë, ka rezultuar se gjatë viteve 2006-2008 **subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme ligjore për të justifikuar 244.094 lekë.**

		2006	2007	2008
1	TË ARDHURA	1.463.093	1.985.508	2.216.669
	të ardhura nga pagat subjekti	1.091.790	1.231.467	1.123.536
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	371.303	454.041	884.909
	të ardhura nga pagat djali	0	300.000	208.224
2	SHPENZIME	922.044	1.109.455	1.178.224
	shpenzime jetese	922.044	922.044	899.832
	shpenzime udhëtimi	0	187.411	278.392
3	PASURI	600.000	900.000	1.200.000
	Kursime	600.000	900.000	1.200.000
	Diferenca (1-2-3)	-58.591	-23.947	-161.556

Tabela 3

Viti 2009:

Është blerë pasuria apartament banimi me sipërfaqe 70.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në godinën “\*\*\*o”, kulla e parë, në komunën Golem, realizuar në bazë të kontratës “Premtim për shitje pasurie të paluajtshme” me nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 23.12.2009, në vlerën 31.000 euro. Burimi i krijimit: nga të ardhurat nga pagat e familjes.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

- ZVRPP Kavajë<sup>17</sup>, ka konfirmuar se nuk rezultojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit apo personave të lidhur. Gjatë komunikimit me subjektin e rivlerësimit, ai ka dhënë shpjegime lidhur me këtë fakt, duke deklaruar se nuk është bërë kalimi i pronësisë me akt noterial i pasurisë objekt i kontratës për premtim shitjeje, nga shitësi z. A. M., dhe për këtë arsye, pasuria nuk është regjistruar në ZVRPP Kavajë.
- Ky apartament është deklaruar në deklaratën për vitin 2009, me burim krijimi kursimet familjare.
- Ky apartament është deklaruar në deklaratën për vetting, e blerë me kontratën për premtim shitjeje nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 23.12.2009 në çmimin e shitjes 31.000 euro, nga të cilat shuma prej 29.000 eurosh është paguar në datën 26.06.2009, ndërsa shuma prej 2.000 eurosh është paguar ditën e lidhjes së kontratës, dt. 23.12.2009. Burim i të ardhurave janë deklaruar të ardhura nga pagat e familjes.
- Gjatë komunikimit elektronik<sup>18</sup>, subjekti ka sqaruar se këtë apartament ai e ka përdorur që në prill ose maj 2009, dhe kontrata është bërë me vonë në mirëbesim mes kolegësh. **Likuidimi i çmimit të shitjes është bërë sipas deklaramit në kontratë. Subjekti nuk ka paraqitur dokumenta që të vërtetojë mënyrën e likuidimit.** Gjatë analizës financiare<sup>19</sup>, është marrë e mirëqenë kontrata e premtimit të shitjes, duke u konsideruar si provë shkresore për vërtetimin e pagimit të vlerës prej 31.000 eurosh, shumë cila është konsideruar si shpenzim për blerjen e kësaj pasurie.

Për këtë pasuri nuk ka pasur pasaktësi në deklarime.

Gjatë analizës financiare për vitin 2009, pasqyruar ne tabelën më poshtë, rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar shumën prej 4.359 lekësh.

<sup>17</sup> Shih shkresën numër \*\*\* prot., datë 13.09.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>18</sup> Shih përgjigjet e subjektit të datës 12.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>19</sup> Shih tabelën nr. 4 të këtij vendimi.

		<b>2009</b>
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>2.484.184</b>
	të ardhura nga pagat subjekti	1.243.333
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	751.689
	të ardhura nga pagat djali	489.162
<b>2</b>	<b>PASURI</b>	<b>3.996.630</b>
<b>3</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.131.913</b>
	shpenzime jetese	899.832
	shpenzime udhëtimi	122.081
	arredim apartamenti sipas pyetësorit	110.000
<b>4</b>	<b>Kursime</b>	<b>-2.640.000</b>
	<b>Diferenca (1-2-3-4)</b>	<b>-4.359</b>

Tabela 4

Viti 2010:

Në këtë vit nuk është deklaruar dhe nuk është blerë pasuri nga subjekti i rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, nga analiza financiare pasqyruar në tabelën më poshtë, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar likuiditetet dhe shpenzimet e kryera gjatë këtij viti.

		<b>2010</b>
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>3.020.803</b>
	të ardhura nga pagat subjekti	1.251.228
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	848.764
	të ardhura nga pagat djali madh	770.811
	të ardhura nga pagat djali vogël	150.000
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.055.616</b>
	shpenzime jetese	944.568
	shpenzime udhëtimi	111.048
<b>3</b>	<b>Kursime</b>	<b>1.600.000</b>
	<b>Diferenca (1-2-3-4)</b>	<b>365.187</b>

Tabela 5

Viti 2011:

Në vitin 2011 është porositur apartament banimi me sipërfaqe 92.26 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në adresën: Rruga “\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt.18.02.2011, me vlerë 6.000.000 lekë. Burimi i krijimit janë deklaruar të ardhurat nga pagat e familjes.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

- ZVRPP Tiranë<sup>20</sup>, konfirmon se pasuria me nr. \*\*\*, figuron e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.
- Është deklaruar në deklaratën për vitin 2011, si apartament i porositur me kontratën e sipërmarrjes me nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* kol, dt.18.02.2011, me çmim shitjeje 6.000.000 lekë, nga të cilat 1.000.000 lekë janë paguar si këst i parë. Burim krijimi për këtë shumë janë deklaruar kursimet familjare.
- Në deklaratimet periodike për vitet 2012, 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen me këste të detyrimit të papaguar, me burim krijimi kursime familjare.
- Është deklaruar për vitin 2015, si pasuri e blerë me kontratën përfundimtare të shitjes me nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 09.07.2015. Në deklarinim për këtë vit, deklarohet shlyerja e detyrimit të mbetur prej 500.000 lekësh nga kursimet familjare.
- Është deklaruar në deklaratën për vetting pasuria me nr. \*\*\*, me vlerë 6.000.000 lekë, duke u deklaruar si burim të ardhurash: të ardhurat nga pagat e familjes.

Lidhur me likuidimin e çmimit të blerjes prej 6.000.000 lekësh rezulton se:

- Në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt.18.02.2011, është caktuar çmim shitjeje 6.000.000 lekë, nga të cilat shuma prej 1.000.000 lekësh është likuiduar jashtë zyrës në cash. Pjesa tjetër nëpërmjet një kredie bankare që do të merret.
- Në kontratën e shitjes nr. \*\*\* Rep., dhe nr. \*\*\* Kol., dt. 09.07.2015, është shkruar se likuidimi i çmimit të shitjes është bërë sipas kontratës së sipërmarrjes (me kredi), ndërkohë që është vërtetuar se subjekti nuk ka marrë kredi sipas përcaktimit në kontratën e sipërmarrjes. **Siç rezulton, janë konstatuar pasaktësi dhe deklarime të pavërteta në kontratën e shitjes, lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes.**
- Subjekti deklaroi në vite se diferenca e çmimit të shitjes prej 5.000.000 lekësh, është paguar prej tij me këste deri në vitin 2015, nga kursimet familjare, shumë nga e cila subjekti ka vërtetuar me dokumenta shkresore (katër mandatpagesa), likuidimin e vlerës prej 4.500.000 lekësh<sup>21</sup>. **Nuk vërtetohet me dokument shkresor likuidimi i shumës prej 500.000 lekësh,** shumë e cila është marrë në konsideratë nga Komisioni si shpenzim

<sup>20</sup> Shih shkresën numër \*\*\* Prot., datë 29.12.2017, në dosjen e KPK-së.

<sup>21</sup> Shih përgjigjet e subjektit të datës 12.02.2018, në dosjen e KPK-së.

gjatë analizës financiare<sup>22</sup>, duke marrë të mirëqenë kontratën e shitjes së pasurisë, si dokument shkresor që vërteton pagimin e kësaj shume.

- Duke qenë se kjo pasuri është porositur në vitin 2011 dhe është blerë me kontratë përfundimtare në vitin 2015, është kryer hetim administrativ lidhur me faktin se kur janë kryer shpenzimet për arredimin e saj në shumën prej 800.000 lekësh<sup>23</sup>.

Pas kërimit nga ana e Komisionit, OSHEE<sup>24</sup> konfirmon se për këtë pasuri është lidhur kontratë nga abonentit K. N., me numër \*\*\*, dhe konsumimi i energjisë elektrike ka filluar në muajin korrik 2016. Gjatë analizës financiare<sup>25</sup>, shpenzimet për arredimin e banesës janë llogaritur në vitin 2016.

Lidhur me kredinë për të cilën subjekti ka aplikuar si i pastrehë për blerjen e pasurisë së mësipërme, është konstatuar se:

- Në deklarin për vitin 2010, subjekti ka përmendur se ka kërkuar një kredi nga BKT me miratim të Gjykatës së Lartë.
- Pasi janë kërkuar të dhëna, ky institucion ka konfirmuar<sup>26</sup>, se i është bërë kërkesë BKT-së, për miratim të një kredie për subjektin Tom Ndreca, në zbatim të VKM-së nr. 600 datë 12.09.2007 “Për trajtim me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, sipas të cilit, përfitues të kredisë e cila subvencionohet nga shteti, janë subjektet të cilët nuk kanë pasuri në pronësi apo kanë sipërfaqe nën normat e strehimit.

Gjithashtu BKT, ka vënë në dispozicion aplikimin dhe të gjithë dokumentacionin për marrjen e kredisë duke vërtetuar se është refuzuar kërkesa për kreditim të subjektit, për shkak se ka pasur apartament në pronësi me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> në Tiranë, dhe ky fakt binte ndesh me udhëzimet dhe rregulloret mbi të cilat mbështetej programi i strehimit për këtë kategori.

- Gjatë komunikimit elektronik<sup>27</sup>, subjekti deklaroi se: *“shkak i moslëvrimit të kësaj kredie nga banka me sa më informuan (kujtoj që informimi u bë me telefon nga banka) ishte se sipërfaqja e banimit për frymë që disponoja ishte më e madhe se ajo e parashikuar në VKM-në për nevojë për strehim”*. Ndërkohë, në parashtrimet e tij të datës 08.07.2018 dhe në seancë degjimore, deklaroi se shkak për kërkimin e kredisë ka qenë se djali i tij i madh kishte krijuar familje dhe kishte nevojë për strehim.

Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka vepruar në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 600 datë 12.09.2007, i ndryshuar, i cili ka përcaktuar kushtet dhe kriteret e përfitimit të kredisë së butë. Subjekti i rivlerësimit i ka pasur të gjitha mundësitë për kështu dhe detyrimin që të njihej me kushtet e kredisë përpara se ai të aplikonte. Në kushtet kur ai nuk i plotësonte kriteret, **me veprimet e tij (kërkesa për strehim) ka kërkuar të përfitojë**

<sup>22</sup> Shih tabelën 6 të analizës financiare në këtë vendim.

<sup>23</sup> Shih përgjigjen e pyetësorit të parë, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2017.

<sup>24</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.02.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>25</sup> Shih tabelën 8 të këtij vendimi.

<sup>26</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.02.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>27</sup> Shih përgjigjet e subjektit të datës 12.02.2018, në dosjen e KPK-së.

**kredi në kundësttim me kërkesat e ligjit, veprime që cenojnë etikën e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.**

Gjatë analizës financiare, pasqyruar në tabelën më poshtë, ka rezultuar se për vitin 2011 subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë e vënë dhe shpenzimet e kryera.

		<b>2011</b>
<b>1</b>	<b>PASURI NETO</b>	<b>1.700.000</b>
	pasuri nr. 6/662+1-2	6.000.000
	detyrim ndaj ndërtuesit	-3.500.000
	Kursime	-800.000
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.384.362</b>
	shpenzime jetese	944.568
	shpenzime udhëtimi	439.794
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>3.417.975</b>
	të ardhura nga pagat subjekti	1.284.214
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	1.203.041
	të ardhura nga pagat djali madh	802.305
	të ardhura nga pagat djali vogël	128.415
	<b>Diferenca (3-1-2)</b>	<b>333.613</b>

Tabela 6

Viti 2012:

Është blerë automjeti i llojit autoveturë tip Golf, me targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes K. N., në vlerën 200.000 lekë dhe burimi i krijimit nga të ardhurat nga pagat e familjes.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

- DPSHTRR<sup>28</sup>, nuk konfirmon që kjo pasuri të jetë regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur.
- Kjo autoveturë është blerë sipas kontratës nr. \*\*\* Rep., nr. \*\*\* Kol, datë 11.07.2012 me çmimin e shitjes 200.000 lekë, kontratë e cila nuk është paraqitur për regjistrim në DPSHTRR.
- Është deklaruar në dekaratën për vitin 2012 dhe në deklaratën për vetting me burim krijimi të ardhura nga kursimet familjare.

Për këtë pasuri nuk ka pasur pasaktësi në deklarime.

<sup>28</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 27.02.2018, në dosjen e KPK-së.

Pas analizës financiare për vitin 2012, pasqyruar në tabelën më poshtë, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë e vënë dhe shpenzimet e kryera.

<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>3.550.387</b>
	të ardhura nga pagat subjekti	1.287.108
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	1.000.928
	të ardhura nga pagat djali madh	803.245
	të ardhura nga pagat djali vogël	459.106
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>1.183.489</b>
	shpenzime jetese	944.568
	shpenzime udhëtimi	238.921
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>1.700.000</b>
	këst apartamenti	1.500.000
	makinë tip Volkswagen Golf ***	200.000
<b>4</b>	<b>Kursime</b>	<b>200.000</b>
	<b>Diferenca (1-2-3-4)</b>	<b>466.898</b>

Tabela 7

Për periudhën 2013-2016:

Nuk është deklaruar dhe nuk është blerë pasuri nga subjekti i rivlerësimit.

Gjatë analizës financiare, pasqyruar si në tabelën më poshtë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar vlerën e pasurisë dhe shpenzimeve për periudhën 2013-2016.

		<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA</b>	<b>3.790.448</b>	<b>4.133.268</b>	<b>3.719.356</b>	<b>2.794.176</b>
	të ardhura nga pagat subjekti	1.563.524	1.595.860	1.576.316	1.566.462
	të ardhura nga pagat bashkëshortja	821.649	866.262	689.849	140.250
	të ardhura nga pagat djali madh	830.279	847.113	836.656	627.954
	të ardhura nga pagat djali vogël	574.996	624.033	616.535	459.510
	të ardhura nga shitja makinës		200.000		
<b>2</b>	<b>SHPENZIME</b>	<b>981.023</b>	<b>1.179.953</b>	<b>1.986.113</b>	<b>982.740</b>
	shpenzime jetese	944.568	944.568	953.484	982.740
	shpenzime udhëtimi	36.455	235.385	232.629	0
	arredim apartamenti sipas pyetësorit			800.000	
<b>3</b>	<b>PASURI</b>	<b>700.000</b>	<b>800.000</b>	<b>500.000</b>	<b>0</b>
	këst apartamenti	700.000	800.000	500.000	0
<b>4</b>	<b>Kursime</b>	<b>1.250.000</b>	<b>1.300.000</b>	<b>1.200.000</b>	<b>-192.655</b>
	<b>Diferenca (1-2-3-4)</b>	<b>859.425</b>	<b>853.315</b>	<b>33.243</b>	<b>2.004.091</b>

Tabela 8



Për periudhën 31.12.2016 - 31.01.2017:

Subjekti ka deklaruar gjendje likuiditeti në 31.12.2016 dhe 31.01.2017 si më poshtë:

	<b>31.12.2016</b>	<b>31.01.2017</b>	<b>SHTESA</b>
CASH	1.197.903	1.500.000	302.097
Credins Bank BSH	3.000.000	3.000.000	0
Raiffesien Bank djali vogël	1.000.000	1.000.000	0
Credins Bank llogari rrjedhëse		1.200.000	1.200.000
<b>TOTAL</b>	<b>5.197.903</b>	<b>6.700.000</b>	<b>1.502.097</b>

Tabela 9

Gjendja e likuiditetit për një muaj është rritur me 1.502.097 lekë.

Është pyetur subjekti në lidhje me burimin e krijimit të shtesës së likuiditetit prej 1.502.097 lekësh, dhe përgjigja e tij<sup>29</sup> është se:

*“mundet që në deklaratën Vetting të mungojë një faqe me të ardhurat e bashkëshortes dhe fëmijëve...”*. Lidhur me këtë pretendim, gjatë hetimit administrativ këto të ardhura (të bashkëshortes dhe fëmijëve) janë marrë parasysh pasi janë deklaruar në deklaratat e viteve përkatëse. Ndërkohë, nga verifikimet ka rezultuar se nuk ka mungesë fletësh në deklaratën për vetting<sup>30</sup>.

*“Mundet që në analizën financiare të mos jenë përfshirë kursimet e viteve 2015 dhe 2016...”*. Në lidhje me këtë pretendim, është konstatuar se kursimet e vitit 2015 janë deklaruar (1.200.000 lekë) dhe janë përfshirë në analizën financiare. Ndërsa në lidhje me kursimet e vitit 2016, është konstatuar se ato nuk janë deklaruar nga subjekti. Por, rezulton që ai ka pasur mundësi për të krijuar këto kursime (pasi diferenca e të ardhurave me shpenzimet është 2.343.974 lekë). Për këto arsye, shtimi i likuiditetit për periudhën 31.12.2016 - 31.01.2017, është i justifikuar. Por, subjekti nuk ka deklaruar këtë shtesë likuiditeti në deklarinimin periodik për vitin 2016.

**Deklarimi për vitin 2016, ka qenë i pasaktë, pasi nuk është përmbushur detyrimi ligjor për deklarinimin e likuiditetit në shumën prej 1.502.097 lekësh.** (ligji nr. 9049/10.04.2003).

#### **Likuiditetet e deklaruara në deklaratën për vetting:**

- Depozitë bankare në Credins Bank, në emër të bashkëshortes K., (dokument librezë e depozitës) në vlerën 3.000.000 lekë, krijuar nga kursimet nga paga.

<sup>29</sup> Shih përgjigjet e datës 12.02.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>30</sup> Shih deklaratën e datës 30.01.2017 në dosjen e ILDKPKI-së.

Gjatë hetimit administrativ është konfirmuar nga Credins Bank<sup>31</sup>, se K. N., ka depozitë bankare në vlerën prej 3.000.000 lekësh. Përputhen deklaratimet.

- Depozitë në llogari personale në Raiffeisen Bank, në emër të djalit E., në vlerën 1.000.000 lekë, krijuar nga kursimet nga paga.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se Raiffeisen Bank<sup>32</sup> ka konfirmuar se ka depozitë në llogari personale në emër të djalit E. N., në shumën 1.000.000 lekë. Përputhen deklaratimet.

- Llogari rrjedhëse në Credins Bank, në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1.200.000,37 lekë, krijuar nga kursimet nga paga.

Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se Credins Bank<sup>33</sup>, konfirmon llogari rrjedhëse me numër \*\*\*, në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1.200.000,37 lekë. Përputhen deklaratimet.

- Të ardhura nga kursimet cash në vlerën 1.500.000 lekë.

Nga hetimi administrativ, sipas analizës financiare, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar këtë likuiditet.

#### **Pasuri të padeklaruar<sup>34</sup>.**

Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se:

- Nuk janë deklaruar likuiditetet e bashkëshortes së subjektit znj. K. N., nga viti 2009-2016, në shumën totale prej 1.204.255 lekësh në një llogari bankare pranë Credins Bank<sup>35</sup>. Në deklaratën për vetting, nuk është deklaruar dhe llogaria e bashkëshortes K. N., me numër \*\*\*, me likuiditet në shumën prej 61.074 lekësh pranë kësaj banke.
- Nuk janë deklaruar likuiditetet e djalit E. N., për vitet 2014, 2015 dhe 2016, në shumën totale prej 146.066 lekësh, në një llogari bankare pranë Credins Bank<sup>36</sup>. Në deklaratën për vetting, nuk janë deklaruar të ardhurat nga paga e djalit E. N., si dhe llogaria e tij me numër \*\*\* në shumën prej 883 lekësh, pranë kësaj banke.
- Nuk janë deklaruar likuiditetet e djalit E. N., për vitet 2012-2016 në shumën prej 138.800 lekësh, në një llogari bankare pranë Raiffeisen Bank.<sup>37</sup> Në deklaratën për vetting, nuk janë deklaruar të ardhurat nga paga e djalit E. N., si dhe llogaria e tij me numër \*\*\* në shumën prej 51.297 lekësh pranë kësaj banke.

<sup>31</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 11.01.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>32</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 19.12.2017, në dosjen e KPK-së.

<sup>33</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 11.01.2018, në dosjen e KPK-së.

<sup>34</sup> Shih paragrafin “gjetje të tjera”, faqen 13 dhe 14 të rezultateve të hetimit paraprak në dosjen e KPK-së.

<sup>35</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* të Credins Bank, datë 11.01.2018 në dosjen e KPK-së.

<sup>36</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* datë 19.12.2017 të Credins Bank në dosjen e KPK-së.

<sup>37</sup> Shih shkresën e RF Bank, në dosjen e KPK-së.

Sa më sipër rezulton se subjekti ka:

**- Deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në deklaratat periodike përkatëse.**

**- Deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në deklaratën për vetting, në kundërshtim me nenin 3, pika 11 dhe 19 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 4 të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003.**

- **Në deklaratën për vetting nuk është deklaruar automjeti me targë \*\*\* në emër të djalit të subjektit, z. E. N.**
- **Në deklarin për vitin 2005, nuk është deklaruar automjeti me targë \*\*\*, në çmimin e blerjes 250.000 lekë, në emër të djalit të subjektit, shtetasit E. N.**
- **Në deklarin për vitin 2016, nuk është deklaruar shtesë likuiditeti në shumën prej 1.502.097 lekësh, nga ana e subjektit z. Tom Ndreca.**

Për këto mosdeklarime, subjekti ka dhënë shpjegime në parashtrimet e datës 08.07.2018, duke deklaruar se janë një harresë nga ana e tij.

Në përfundim të hetimit administrativ, për rivlerësimin e pasurisë, pas analizës financiare<sup>38</sup> ka rezultuar se gjatë periudhës së rivlerësimit, **subjekti ka në total një likuiditet të pajustificuar nga burime te ligjshme në shumën prej 1.393.336 lekësh.**

### **II.3 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.**

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: Tirana Bank<sup>39</sup>, Procredit Bank<sup>40</sup>, Credins Bank<sup>41</sup>, Raiffeisen Bank<sup>42</sup>, Intesa Sanpaolo Bank<sup>43</sup>, si dhe gjendjet cash të deklaruara nga subjekti<sup>44</sup>.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen: (i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë për periudhën 21.12.1991 – 25.04.1994<sup>45</sup>; të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Apelit Tiranë për periudhën 16.04.1994 – 26.04.2013<sup>46</sup>; të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë për periudhën

<sup>38</sup> Shih tabelat në këtë vendim,

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* dt. 21.12.2017, në dosjen e KPK-së.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* dt. 03.01.18, në dosjen e KPK-së.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* dt. 12.01.18, në dosjen e KPK-së.

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* dt. 19.12.17, në dosjen e KPK-së.

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\*dt. 21.12.2017, në dosjen e KPK-së.

<sup>44</sup> Shih deklarinimet peroidike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>45</sup> Shkresa nr. \*\*\* Prot., datë 18.01.2017 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

<sup>46</sup> Shkresa nr. \*\*\* dt. 14.10.2016 e Gjykatës së Apelit Tiranë.

26.04.2013 – 31.12.2016<sup>47</sup>; (ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Rubik për periudhën 01.01.1992 – 31.12.1993<sup>48</sup>; të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Rubik për periudhën 01.01.1994 - 01.04.1998<sup>49</sup>; të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Fakultetit të Gjeologji Miniera për periudhën 2010 - 2011, 2015 - 2016<sup>50</sup>; të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Institutit të Studimeve e Projektive të Gjeologjisë Tiranë për periudhën nga 01.04.1998 - 31.10.2006<sup>51</sup>; të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për periudhën 01.11.2006 – 31.12.2007<sup>52</sup>; të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit pranë Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit për periudhën 01.01.2008 – 30.09.2015<sup>53</sup>; (iii) Të ardhurat nga pagat e djalit E.N pranë avokat A.SH., për periudhën 01.10.2007 – 31.12.2007<sup>54</sup>; të ardhura nga pagat e djalit pranë Ministrisë së Drejtësisë për periudhën 2008 - 2016<sup>55</sup>; (iiii) Të ardhura nga pagat e djalit E.N., pranë avokat I.M., për periudhën janar 2010 – 30.10.2010<sup>56</sup>; të ardhura nga pagat e djalit E.N., pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 08.03.2011 – 08.07.2011<sup>57</sup>, të ardhura nga paga e djalit E.N., pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për periudhën 05.03.2012-30.09.2016<sup>58</sup>.

c. Shpenzimet, ku përfshihen: (i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së njef, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT) <sup>59</sup>; (ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. (iii) Shpenzime arredimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga KPK.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>60</sup>.

Vlen të theksohet se, shpenzimet për energjinë elektrike në total për periudhën 2007-2016 janë në vlerën prej 1.211.334 lekësh, llogaritur pasi OSHEE ka dërguar të dhëna për këto shpenzime<sup>61</sup>.

<sup>47</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 20.01.2017 nga Gjykata e Lartë.

<sup>48</sup> Shkresa nr. \*\*\* dt. 28.12.2016 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

<sup>49</sup> Shkresa pa nr. pa date nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

<sup>50</sup> Shkresa pa nr. datë 23.01.2017 Universiteti Politeknik, Fakulteti i Gjeologji Miniera.

<sup>51</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 25.10.2016 nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

<sup>52</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 25.10.2016 nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

<sup>53</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 19.12.2016 nga Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

<sup>54</sup> Shkresa datë 21.01.2017 Avokat A.SH., në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>55</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 17.10.2016 Ministria e Drejtësisë, në dosjen e ILDKPKI-së

<sup>56</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 24.01.2017 Avokat I.M., në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>57</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 27.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>58</sup> Shkresa nr. \*\*\* datë 25.10.2016 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

<sup>59</sup> Shih vendimin nr. 02 datë 22.06.2018, bashkangjitur tabela për shpenzimet mujore për konsum, në dosjen e KPK-së.

<sup>60</sup> Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>61</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.02.2018 në dosjen e KPK-së.

(Për një muaj shpenzimet janë mesatarisht 10.000 lekë). Këto shpenzime nuk janë llogaritur si shpenzime më vete, por janë konsideruar të përfshira në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së njef, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT).

#### **II.4. Në lidhje me parashtrimet e subjektit pasi ka ushtruar të drejten e barrës së provës.**

Në datën 08.07.2018 subjekti ka paraqitur parashtrësë me pretendimet e tij, si vijojnë:

1. Subjekti pretendon se apartamenti i deklaruar dy herë në vitin 2003, një herë me çmimin 3.000.000 lekë dhe një herë në çmimin e shitjes prej 2.400.000 lekë, është i njejtë apartament, sot pasuria me nr. \*\*\*. Gjithashtu pranon se janë bërë lapsuse gjatë llogaritjes së çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazhit<sup>62</sup>.

Lidhur me këtë pretendim, Komisioni ka konstatuar se në deklarin për vitin 2003, bëhet fjalë për të njejtën pasuri. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit + garazhin, i deklaruar në vitin 2003 në shumën prej 3.000.000 lekësh, ndërkohë që vlera reale është 2.868.000 lekë, Komisioni e ka konsideruar këtë pasaktësi si lapsus nga ana e subjektit, dhe ka llogaritur si shpenzim për blerjen e tyre shumën prej 2.868.000 lekësh. (arsyetuar më sipër në këtë vendim).

2. Subjekti pretendon se mospërputhja lidhur me çmimin e blerjes së banesës në Rëshen, në deklaratën për vetting (550.000 lekë) dhe në atë të vitit 2003, (800.000 lekë), ka ardhur si rezultat se në deklaratën për vetting nuk është përfshirë çmimi i shitjes së orendive shtëpiake prej 250.000 lekësh, fakt për të cilin ai nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion.

Lidhur me këtë pretendim, Komisioni përveçse ka konstatuar mospërputhjen në deklarime, konstaton se subjekti nuk e ka deklaruar pjesën prej 250.000 lekësh si çmim i shitjes së orendive, as në deklaratën për vitin 2003 dhe as në deklaratën për vetting, dhe për këtë arsye kjo shumë nuk është marrë në konsiderate si e ardhur e ligjshme gjatë analizës financiare.

3. Përsa i përket huasë së marrë nga motrat dhe vëllezërit në shumën prej 800.000 lekësh, e deklaruar prej 900.000 lekësh në vitin 2003, subjekti pranon mospërputhje në deklarime të cilat janë bërë me aq sa mbante mend. Gjithashtu, pranon se nuk ka pasur dokumente vërtetuese as për marrjen dhe as për shlyerjen e huave, për shkak të një marrëdhënieje kaq të posaçme (vëllezër-motra).

Lidhur me këtë pretendim gjatë analizës financiare, Komisioni i ka marrë në konsideratë huatë dhe shlyerjen e tyre sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën për vetting, edhe pse për dhënien apo për shlyerjen e tyre nuk janë paraqitur dokumente shkresore. (arsyetuar më sipër në këtë vendim).

4. Lidhur me pasurinë nr. \*\*\*, garazh me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 2003, në parashtrimet e tij subjekti deklaroi edhe një herë atë çfarë ka deklaruar në deklaratën për vetting, lidhur me

<sup>62</sup> Shih faqen 2 dhe 3 të parashtrimeve të subjektit në dosjen e KPK-së, të datës 13.07.2018.

mospagimin e çmimit të shitjes për garazhin, për shkak të punimeve të kryera prej tij në garazh në shumën prej 468.000 lekësh, pa ngritur asnjë pretendim<sup>63</sup>. (lidhur me deklaratimet për garazhin, është arsyetuar me sipër në këtë vendim).

5. Përsa i përket pasaktësisë lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes së pasurisë me nr. \*\*\*, me vlerë 6.000.000 lekë, subjekti pranon që nuk mund të vërtetohet me dokument shkresor likuidimin e shumës prej 500.000 lekësh në vitin 2015, por është përcaktuar në kontratën e shitjes likuidimi total i çmimit të shitjes. Po kështu ka dhënë shpjegime lidhur me mospërputhjet në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes<sup>64</sup>.

Lidhur me këto pretendime nga ana e Komisionit, siç është arsyetuar më sipër në këtë vendim, shuma prej 500.000 lekësh si këst i fundit për blerjen e pasurisë, është marrë në konsideratë nga ana e Komisionit edhe pse nuk është vërtetuar me dokument shkresor, për shkak se është vërtetuar likuidimi i saj me kontratën e shitjes. Përsa i përket mospërputhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të shitjes, Komisioni i ka konstatuar këto mospërputhje si ekzistente, dhe vlerëson se pavarësisht shpjegimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, ka qenë detyrimi i tij ligjor që të sqaronte mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes në kontratën përfundimtare të shitjes, dhe të shmangte nënshkrimin e nje akti noterial që përmbante fakte të pavërteta lidhur me pagimin e çmimit të shitjes. Ndërkohë, nuk është konstatuar në asnjë moment të hetimit administrativ, se të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie janë nga burime të paligjshme, siç del nga pretendimet e subjektit.

6. Përsa i përket kredisë për të cilën ka aplikuar me statusin e të pastrehut, subjekti pretendon se është bërë kërkesë për zgjerim të sipërfaqes së banimit për shkak se ka pasur dy djem të rritur, njëri prej të cilëve E., donte të martohej.

Lidhur me këtë pretendim Komisioni vlerëson se nevojat e subjektit për strehim për shkaqet që paraqet, nuk mund ta legjitimonin atë për të kërkuar një kredi lehtësuese, në kushtet kur nuk i përmbushte kriteret ligjore për përfitimin e saj.

7. Përsa i përket mosdeklarimit të kursimeve për vitin 2016, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjekti deklaroi se kjo ka ndodhur për shkak se ky fakt është deklaruar në deklaratën e dorëzuar për vetting në janar të vitit 2017 dhe nuk u ripasqyrua në deklaratimin periodik vjetor të vitit 2016, me mendimin se ndoshta konsiderohen dy herë për të njejtën periudhë këto kursime (viti 2016).

Lidhur me këtë pretendim, (subjekti është i pasaktë dhe i paqartë) Komisioni ka konstatuar pasaktësi në deklaratimin e kursimeve për vitin 2016, për shkak të detyrimit ligjor për të deklaruar të ardhurat në mënyrë të saktë si në deklaratën vetting (detyrim i ligjit nr. 84/2016) dhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 (detyrim i ligjit nr. 9049 dt.10.04.2003).

<sup>63</sup> Shih faqen 4 të parashtrimeve të subjektit në dosjen e KPK-së, të datës 13.07.2018.

<sup>64</sup> Shih faqen 4 dhe 5 të parashtrimeve të subjektit në dosjen e KPK-së, të datës 13.07.2018.

8. Përsa i përket mosdeklarimit të llogarive bankare të bashkëshortes K. N., djalit E. N., dhe djalit tjetër E. N., subjekti pretendon se këto janë llogari rrjedhëse nga pagat, duke pranuar mosdeklarimin si gabim njerëzor.

Lidhur me këto llogari, Komisioni, pasi ka verifikuar që janë llogari rrjedhëse me të ardhurat nga pagat si dhe ka verifikuar se subjekti ka deklaruar rregullisht në vite keto të ardhura për veten dhe personat e lidhur (me përjashtim të deklaratës për vetting), ka konstatuar vetëm pasaktësi dhe deklarime të pamjaftueshme në deklaratimet periodike përkatëse dhe deklaratën për vetting, për shkak të mosdeklarimit të llogarive bankare me likuiditetet përkatëse, të përmendura më sipër në këtë vendim, si dhe për shkak të mosplotësimit të formularit për deklarimin e pasurive për vetting nga ana e personave të lidhur sipas ligjit nr. 9049 dt. 10.04.2003.

Vlen të theksohet se, Komisioni nuk i ka konsideruar shumat e padeklaruara si fshehje pasurie, duke qenë se, në deklaratimet periodike janë deklaruar burimet për krijimin e tyre, që janë të ardhurat nga pagat.

9. Përsa i përket mosdeklarimit dhe fshehjes së pasurisë për automjetin tip Mercedes Benz targë \*\*\*<sup>65</sup>.

Komisioni ka konstatuar pasaktësinë e deklaratës për vetting për shkak të mosdeklarimit të autoveturës me targë \*\*\*, autoveturë e cila sipas vërtetimit me nr. \*\*\* datë 21.12.2017, dhe vërtetimit me nr. \*\*\* prot., datë 21.02.2018, të lëshuara nga DPSHTRR, figuron i regjistruar në emër të djalit të subjektit, z. E. N. Gjatë parashtrësës së tij, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë që të kundërshtojë këtë fakt.

Subjekti ka pasur mundësinë dhe detyrimin ligjor, që përpara se të plotësonte deklaratën e pasurisë për vetting, të verifikonte pranë çdo institucioni pasuritë e regjistruara në emër të tij dhe të personave të lidhur. Mospërmbushja e këtij detyrimi, përveçse është shkelje ligjore, tregon papërgjegjshmëri të subjektit në plotësimin e deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër, as pretendimet e subjektit në parashtrësë dhe as deklarata noteriale e paraqitur prej tij, nuk e justifikojnë mosdeklarimin e autoveturës me targë \*\*\*, sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003, ndërkohë që neni 33 pika “c” i ligjit nr. 84/2016, e konsideron këtë si fshehje pasurie.

10. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk ndodhet në kushtet e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurive të ligjshme:

Komisioni konstaton se në asnjë moment gjatë procesit të rivlerësimit dhe as në rezultatet paraprake të hetimit, nuk është përmendur që subjekti ndodhet në kushtet e pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Veç kësaj, kjo dipozite ligjore, parashikon vetëm një nga kriteret e mundshme për shkarkimin nga detyra të subjektit.

<sup>65</sup> Shih faqen 7 dhe 8 të parashtrimeve përfundimtare të subjektit të datës 13.07.2018, në dosjen e KPK-së.

11. Lidhur me likuiditetet, subjekti i rivleresimit ka paraqitur “Analizë të pasurisë dhe të të ardhurave të subjektit të rivleresimit Tom Ndreca”. (Periudha 1980-2016).

- Subjekti i rivlerësimit pretendon se:

*“Unë dhe familja ime, kam krijuar të ardhura të majftueshme nga paga, duke filluar që nga viti 1980, të cilat sipas aktit të ekspertimit (refero në fq. 5) për periudhën 1980-2003, janë në shumën 6.872.375 lekë (kjo vlerë referuar vërtetimeve të pagave për periudhën 1991-2003 dhe pagës neto pasqyruar në librezat e punës edhe për periudhën 1980-1991, refero në faqen 5 të aktit të ekspertimit).*

*Po për këtë periudhë, të ardhurat totale (pagat + borxhi i vëllezërve dhe motrave 900.000 lekë + shitja e apartamentit në Rrëshen në vlerën 550.000 lekë) arrin në shumën 8.366.789 lekë (refero akt ekspertimi në faqen 5-7 të tij).*

*Vlera e pasurive të krijuara gjatë kësaj periudhe arrin në shumën 3.168.000 lekë e përbërë nga: vlera e apartamentit (2.400.000 lekë) + garazh (468.000 lekë) + vlerën e automjetit të deklarimit të vitit 2003 (300.000 lekë).”*

*Vlera e shpenzimeve të po të kësaj periudhe: (shpenzime jetese, arredime, udhëtime, etj., referuar KPK-së) është në shumën 3.748.789 lekë. Pra, shumatorja e shpenzimeve të kryera gjatë periudhës në referim arrin në vlerën totale prej 6.916.789 lekësh (refero aktin e ekspertimit fq. 7).*

*Sa rezulton më sipër, të ardhurat e mia në periudhën e referimit kanë mundësuar shpenzimet e kryera, pra vënien e pasurisë dhe shpenzimet e tjera të sipërpërmendura, duke krijuar mbetjen e një gjendjeje monetare në vlerën e 1.405.586 lekë.*

Lidhur me këtë pretendim pas rishikimit të analizës financiare, rezulton se periudha 1994-2003 ka dalë pozitive, pra subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pasurinë e krijuar.

Sa i përket gjendjes monetare të pretenduar prej 1.405.586 lekësh të krijuar përpara vitit 2003, rezulton se kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të vitit 2003, në të cilën nuk është deklaruar asnjë gjendje likuiditeti (detyrim i ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003).

- Subjekti pretendon se:

*“Nga sa mund të shihet nga përlllogaritjet, duket se gjendja e mbartur nga periudhat në vazhdim (1980-2003) dhe të ardhurat e përfituara gjatë vitit, kanë mbuluar shpenzimet e kryera dhe kanë krijuar një gjendje në fund të vitit 2004 në shumën 1.255.586 lekë”.*

Lidhur me këtë pretendim, rezulton se totali i likuiditeteve të deklaruara nga subjekti dhe të marra si bazë në analizën financiare në fund të vitit 2004, ka qenë 250.000 lekë dhe jo 1.255.586 lekë.

- Subjekti pretenon se: *“Gjendja e mbartur nga periudhat në vazhdim (1980- 2004) dhe të ardhurat e përfituara gjatë vitit, kanë mbuluar shpenzimet e kryera dhe kanë krijuar një*



*gjendje në fund të vitit 2005, në shumën 1.119.951 lekë (për më tepër, referoju aktit të ekspertimit fq. 10-11).*

Lidhur me këtë pretendim, rezulton se shuma e deklaruar prej subjektit dhe e marrë si bazë në analizën financiare për vitin 2005, është 700.000 lekë, dhe jo 1.119.951 lekë.

- Subjekti pretendon se: *“Ndikim në periudhën 2004-2008 ka edhe përfshirja e shpenzimeve për arredim në vlerën 1.700.000 lekë të deklaruara gjatë komunikimit elektronik, në përgjigje të pyetjes nr. 11, të pyetësorit nr. 1. Ky arredim nuk i përket vetëm periudhës 1994 - 2003, por është i shtrirë gjatë gjithë periudhës 1990-2016. (Për më tepër referoju aktit të ekspertimit fq. 8). Kjo për faktin se besoj se është logjike që konsumimi dhe amortizimi i sendeve shtëpiake është gradual dhe passjell zëvendësimin po gradual të tyre.”*

Lidhur me këtë pretendim, rezulton se shuma e arredimit prej 1.700.000 lekësh<sup>66</sup>, sipas deklarimit të subjektit, është marrë në konsideratë në periudhën 1994-2003, periudhë e cila rezulton me burime të mjaftueshme. Nga analiza financiare, pasqyrohet qartë se nuk janë përfshirë shpenzime arredimi pas vitit 2004, gjë e cila është në favor të subjektit.

- Subjekti pretendon se: *“Vërej se në analizën tuaj huaja e vëllezërve dhe e motrave, nuk është llogaritur në kohën e marrjes si ardhur, por vetëm si detyrim i shlyer në vitet 2004-2005.”*

Lidhur me këtë pretendim, konstatohet se është i pabazuar, pasi shuma e huasë prej vëllezërve është marrë për bazë gjatë analizës financiare për periudhën 1994-2003, siç dhe është deklaruar nga subjekti, ndërsa shlyerja e saj është llogaritur në vitin 2004 (400.000 lekë) dhe në vitin 2005 (500.000 lekë), përsëri sipas deklarimit të subjektit.

Në konkluzion, lidhur me pretendimet për likuiditetet e pamarra në konsideratë gjatë analizës financiare, të përshkruara si më sipër, rezulton se çdo shumë e pretenduar nga subjekti si gjendje likuiditeti, nuk është deklaruar prej tij në deklaratat periodike sipas detyrimit të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003, dhe për rrjedhim nuk mund të merret në konsideratë gjatë analizës financiare. Vlen të theksohet se analiza financiare është bërë që nga viti 1994-2003, bazuar në deklarimet për vitin 2003, si dhe analiza financiare për vitet në vazhdim, është bazuar në deklaratat periodike të subjektit për çdo vit si dhe çdo dokumentacion vërtetues për të ardhurat e ligjshme të subjektit të administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

Ndërkohë, u konstatua se, pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument tjetër, të ndryshëm nga ato të administruara në dosje, për të vërtetuar pretendimet e tij.

<sup>66</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit të parë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2017 në dosjen e KPK-së.

## II.5. REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË HETIMIT ADMINISTRATIV PËR PASURITË.

Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me vlerësimin e pasurive sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë marrë në konsideratë edhe shpjegimet, dokumentet e paraqitura nga subjekti në ushtrim të së drejtës së barrës së provës sipas parashtrimeve të datës 08.07.2018, si dhe parashtrimet e tij seancë dëgjimore, Komisioni ka konstatuar se:

Ne deklarimet periodike:

- ✓ Ka deklarime të pamjaftueshme, deklarime të pasakta, si dhe disa mospërputhje me deklaratën për vetting, të përmendura më sipër në këtë vendim. Sipas nenit 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasaktësitë e konstatuara në deklarimet periodike konsiderohen si prova nga Komisioni, me anë të të cilave vërtetohet fakti se subjekti në çdo rast të deklarimeve të pasakta apo mosdeklarimeve, ka vepruar (ose mosvepruar) në kundërshtim me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003.

Në deklaratën për vetting:

- ✓ Bashkëshortja dhe dy fëmijet, të cilët kanë pasur pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre, kanë plotësuar vetëm autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, duke deklaruar dhe nënshkruar se nuk disponojnë pasuri veçmas, (deklarim i remë) ndërkohë që kanë pasur detyrimin për të plotësuar secili deklaratën e pasurive, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur ligjit nr. 84/2016, parashikuar nga neni 31 i tij.  
Si rrjedhim, ka deklarim të pamjaftueshëm dhe deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 84/2016. (neni 33 pika 5/a)
- ✓ Deklarim të pamjaftueshëm dhe deklarim të pasaktë për shkak të mosdeklarimit të likuiditeteve në shumën totale prej 113.254 lekësh, (në emër të bashkëshortes dhe fëmijëve) në kundërshtim me ligjin nr. 9040 datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjin nr. 84/2016. (neni 33 pika 5/a).
- ✓ Ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar likuiditetetin në shumën prej 1.393.336 lekësh. (neni 33 pika 5/b e ligjit).
- ✓ Fshehje pasurie, autoveturë me targë TR 8172 F. (neni 33, pika 5 germa “c” e ligjit).
- ✓ Deklarim i rremë lidhur me çmimin e blerjes së garazhit. (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit).

- ✓ Deklarim i rremë, i bashkëshortes dhe fëmijëve në autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, në pjesën “*nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim*”, (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit).

### **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME PASTËRTINË E FIGURËS.**

#### **III.1 Vlerësimi i figurës nga DSIK.**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, me raportin e dërguar me shkresën nr. \*\*\* datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. 8 datë 08.01.2018 të K.D.Zh-së, ky institucion ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca.

#### **III.2 Hetimi administrativ për rivlerësimin e figurës nga ana e Komsionit.**

Ky hetim ka konsistuar në:

- a. Verifikimin e faktit nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.
- b. Verifikimin nëse ka informacione që tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- c. Konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës, me qëllim vërtetimin e faktit nëse subjekti ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 39 të këtij ligji.

Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se:

- Në datën 11.07.2012 është lidhur kontrata e shitjes së mjetit me numër \*\*\*/11.07.2012, midis shitësit N. N. Gj., dhe blerëses K. N. G., e cila është bashkëshortja e subjektit Tom Ndreca.
- Duke qenë se shtetasi N. G., është kunati i subjektit të rivlerësimit, sipas formularit të deklaramit (shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016) ai është “**anëtar familjeje**” me subjektin.

- Për shtetasin N. G., ka pasur informacion se është person me precedent kriminal. Lidhur me këtë fakt Komisioni ka kryer disa kërkime. Në përfundim të hetimeve ka rezultuar se për shtetasin N. G., i cili është arrestuar në datën 09.11.2011 dhe është liruar nga burgu në datën 05.12.2011, ka filluar procedimi penal me nr. 1197 i vitit 2011, dhe në datën 20.03.2012 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë vendimi për pushimin e hetimeve në ngarkim tij, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të K. Penal “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”.
- Për shkak të rrethanave të reja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka riparë vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit në raportin nr. \*\*\* Prot., datë 02.11.2017, dhe ka vënë në dispozicion të KPK-së raportin nr. \*\*\* Prot., datë 20.06.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të K.D.Zh-së nr. 2002 datë 22.06.2018, nga i cili rezulton se:

1. Sipas nenit 3 pika 15 e ligjit nr. 84/2016, shtetasi N. Gjeci hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, dhe subjekti nuk e ka deklaruar këtë fakt gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 pika 2 të ligjit nr. 84/2016, duke e ngarkuar me përgjegjësi e fshehjes së një fakti dhe plotësimit të pasaktë dhe jo me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.

2. Informacionet që disponohen në ngarkim të shtetasit N. G., evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, DSIK, institucioni kompetent për vlerësimin e figurës së subjekteve të rivlerësimit, për përmbushje të procedurave ligjore sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Në thellim të hetimit administrativ, me qëllim vërtetimin e çdo fakti e rrethane që ka lidhje me pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, janë analizuar shkresat e protokolluara në KPK, lidhur me 11 denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Ka rezultuar se në asnjë rast, denoncimet nuk përmbajnë prova dhe të dhëna konkrete, që kanë lidhje me pastërtinë e figurës së subjektit.

### **III.3 NË LIDHJE ME PARASHTRIMET E SUBJEKTIT PËR PASTËRTINË E FIGURËS.**

Përsa i përket vlerësimit të figurës, në parashtrimet e tij të datës 08.07.2018 si dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka deklaruar se:

*“Nuk mund të mohoj aspak se unë nuk kam qenë në dijeni të faktit të arrestimit të shtetasit N.GJ., kunatit tim, në fund të vitit 2011, për shkak se atij i ishte gjetur me vete një sasi lëndësh narkotike*

*për përdorim vetjak, por nuk e kam deklaruar faktin e mësipërm pasi nuk kam pasur dijeni në lidhje me rrethanat procedurale dhe disponimin e organit procedues deri në momentin që jam njohur me rezultatet e hetimit në datën 29 qershor 2018...”*

Duke pranuar mosdeklarimin e këtij fakti gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, subjekti vijon : “...nuk ka qenë qëllim fshehja e këtij fakti...”

Lidhur me sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti nuk mohon që ka qenë në dijeni të faktit se kunati i i tij është arrestuar në vitin 2011, për shkak se i është gjetur një sasi lëndësh narkotike për përdorim vetjak, por, pretendon se nuk ka qenë në dijeni të rrethanave procedurale të organit procedues.

Sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutes, subjekti ka pasur detyrimin për plotësimin e detajuar të deklaratës për figurën e tij, që mbulon periudhën nga data 01.01.2012 deri ditën e deklarimit.

Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, ka qenë në dijeni të faktit që në vitin 2011 kunati i tij, shtetasi N. G., ka qenë i arrestuar, (por nuk ishte në dijeni të procedurave të ndjekura nga organi i akuzës) ai ka pasur detyrimin ligjor si subjekt rivlerësimi (penalist, anëtar i Gjykatës së Lartë), që përpara se të plotësonte deklaratën për kontrollin e figurës, të bënte të gjitha verifikimet e nevojshme për t’u qartësuar lidhur me procedurat ligjore të ndjekura nga organi i akuzës për “personin e lidhur” N. G., me qëllim plotësimin e saj me vërtetësi e saktësi, sipas detyrimit kushtetues.

Jo vetëm që këtë nuk e ka bërë, por në parashtresën e tij subjekti deklaroi se “... në mënyrë thujtëse automatike, e kam konsideruar të përfshirë në këtë kategori veprën e mbajtjes së lëndësh narkotike, sipas nenit 283 të K. P.” duke pranuar kështu në mënyrë indirekte, se ka qenë në dijeni të faktit që kunati i tij ka qenë i akuzuar për këtë veprë penale, ndërkohë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e këtij fakti.

Përsa i përket pretendimeve për pikën 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, kjo dispozitë jep përkufizimin e “krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit”. Komisioni, vlerëson se argumentat e subjektit lidhur me këtë pikë, (subjekti përmend llojet e veprave penale të parashikuara në nenin 75/a të K.Pr.Penale, në të cilat nuk përfshihet neni 283 i K.Penal) nuk mund të merren në konsideratë në rastin konkret, përderisa formulari shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016, deklarata për kontrollin e figurës (pjesa e pestë), kërkon posaçërisht që subjekti të deklarojë nëse një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

Është pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, e cila jep përkufizimin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, dhe konsideron si të tillë çdo person të dënuar ose proceduar penalisht për veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009. Kjo dispozitë ligjore përmban ndër të tjera dhe veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike (neni 283 i K. Penal).

Nga aktet rezulton se për shtetasin N. G., ka filluar procedimi penal me nr. 1197 të vitit 2011, për veprën penale të parashikuar në nenin 283 të K.Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, procedim i cili është pushuar në datën 20.03.2012 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndërkohë, në po të njejtën datë (20.03.2012) organi i akuzës, ka pezulluar hetimin për të njejtin procedim penal, atë me numër 1197 të vitit 2011, për shkak se nuk janë gjetur autorët e veprës penale.

Si rrjedhim, duke qenë se shtetasi N. G., është proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i K. Penal, hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, parashikuar nga pika 15 e ligjit nr. 84/2016, dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për ta deklaruar këtë fakt.

Lidhur me argumentet e paraqitura për qëllimin e ligjit nr. 10192 datë 02.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar...” Komisioni vlerëson se këto argumente, nuk kanë asnjë rëndësi dhe as lidhje me vlerësimin e figurës së subjektit Ndreca. Pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, i referohet këtij ligji, vetëm për të bërë të qartë llojet dhe kategoritë e veprave penale, për të cilat është dënuar apo proceduar penalisht një person, për t’u konsideruar si person i përfshirë në krimin e organizuar.

Përsa i përket pretendimit se në aspektin penal sipas formulimit të nenit 283 të K.Penal, mbajtja e lëndës narkotike në doza të vogla dhe për përdorim personal nuk përbën vepër penale (por përbën shkak të plotë pafajësie), Komisioni vlerëson se është e vërtetë që përkufizimi i nenit 283 të K. Penal, përjashton nga dënimi rastin e përdorimit vetjak dhe në doza të vogla. Por, siç rezulton e vërtetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. 25/1 datë 12.04.2018, dhe dy vendimet e pushimit/pezullimit bashkangjitur, vërtetohet plotësisht se **shtetasi N. G., është proceduar penalisht sipas nenit 283 të K. Penal, jo vetëm si përdorues i lëndëve narkotike për sasinë prej 0.435 gr., por edhe për mbajtje të sasisë prej 6 kg e 134 gr., lëndëve narkotike.**

Lidhur me pretendimin e subjektit gjatë seancës degjimore, se pushimi i një vepre penale duhet të barazohet me një vendim pafajësie të formës së prerë, Komisioni arsyeton se:

Pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është shumë e qartë kur:

- ✓ përcakton se personi i përfshirë në krimin e organizuar, është çdo person i dënuar (me përjashtim të rastit kur është i deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë) ose proceduar penalisht. (është e vërtetuar se shtetasi N. G., është proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283 të K. Penal).
- ✓ përcakton se personi do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar, **edhe** në rastet e parashikuara në germa a dhe b.

- a. Personi do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar, (përveç rasteve të tjera të pushuara si në rastin e shtetasit N. Gj.), edhe kur procedimi penal ndaj tij pushohet nga organi procedues, për shkak të vdekjes, ose sepse personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet.
- b. Personi do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe në rastin kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet.

Përsa i përket rrethanës lehtësuese të pretenduar nga subjekti, parashikuar nga germa “b” pika 5 e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, kjo dispozitë parashikon si rrethanë lehtësuese marrëdhënien e largët familjare të subjektit të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar, ose ka kontakte familjare të ralla.

Lidhur me këtë pretendim, komisioni konstatoi se, ndërkohë që marrëdhënien me shtetasin N. G., vëllai i bashkëshortes së tij, subjekti e ka konsideruar të largët, në parashtrësën e tij lidhur me huatë e marra nga motrat dhe vëllezërit e tij<sup>67</sup>, këto lloj marrëdhëniesh i ka konsideruar “kaq të posaçme” dhe “tejskajshmërisht të mira”.

Nga parashtrimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, por edhe në seancë, ai nuk paraqiti fakte e rrethana që të vërtetojnë se marrëdhëniet midis tij dhe shtetasit N. Gj., të jenë të largëta dhe të ralla. Përkundrazi, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se në datën 11.07.2012, rreth katër muaj nga dita që janë pushuar hetimet në ngarkim të shtetasit N. G., ky i fundit ka lidhur një kontratë shitje automjeti me motrën e tij dhe bashkëshorten e subjektit znj. K. N., gjë që bie në kundërshtim me pretendimet e subjektit për marrëdhënie të largëta e të ralla midis tyre. Madje, vërehet se subjekti nuk e ka përmendur këtë fakt në parashtrësën e tij, edhe pse është shtjelluar në rezultatet paraprake të hetimit që atij i janë vënë në dispozicion, duke e anashkaluar kontaktin me kunatin e tij.

Përveç sa më sipër, DSIK, institucioni kompetent për vlerësimin e figurës, e ka konsideruar lidhjen e kontratës së shitjes së mjetit, si rrethanë për ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm të subjektit me personin e përfshirë në krimin e organizuar, shtetasin N. Gj., (i cili është konsideruar edhe si person tjetër i lidhur, sipas nenit 3 pika 14 e ligjit nr. 84/2016) dhe konsideron që janë përmbushur kriteret e nenit 4 pika c të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, nga të gjitha deklaratimet e parashtrimet e subjektit, si para ashtu dhe gjatë seancës degjimore, Komisioni vlerëson se:

Subjekti i rivlerësimit Tom Ndreca ka qenë në dijeni të faktit që kunati i tij, shtetasi N. G., i arrestuar në vitin 2011, ka qenë i proceduar penalisht për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodi Penal, dhe si i tillë hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parashikimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>67</sup> Shih parashtrimet e datës 08.07.2018, (fjalja e fundit e faqes nr. 2).

Në këto rrethana, vërtetohet se konstatimi i DSIK-së, lidhur me pasaktësinë gjatë plotësimit të formularit për pastërtinë e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, është i bazuar, dhe sipas parashikimit të nenit 39 pika 2 të ligjit nr. 84/2016, e ngarkon atë me përgjegjësinë e mosplotësimit të saktë dhe jo me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës. Për këtë shkak, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit, derisa ai nuk ka mundur të provojë të kundërtën, sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

#### **IV. KOMUNIKIMI ME SUBJEKTIN.**

Pavarësisht se subjekti ka qënë i gatshëm për bashkëpunim me Komisionin gjatë procesit të rivlerësimit, ai nuk ka mbajtur qëndrim reflektues ndaj gjetjeve të Komisionit, sjellje e cila është mbajtur në konsideratë në procesin e vendimarrjes, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

#### **V. SEANCA DËGJIMORE.**

Në datën 17.07.2018, u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Tom Ndreca, gjatë të cilës ai parashtrroi pretendimet e tij.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit, paraqiti përgjithësisht të njejtat parashtrime, të cilat subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, pasi atij i ka kaluar barra e provës.

Trupi gjykues, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe pastërtisë së figurës, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Tom Ndreca, vlerësoi se ato janë plotësisht të mjaftueshme për procesin e vendimarrjes për këtë subjekt referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Përsa i përket kriterit të vlerësimit profesional, pasi është administruar raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nga Inspektorati i Lartë i KLD-së, si dhe 11 denoncime të publikut të paraqitura pranë Komisionit në adresë të subjektit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka filluar, por nuk ka përfunduar procesin e hetimit administrativ lidhur me këtë kriter.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi dëgjoji subjektin i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore: Aneks 1 - dosja e ILDKPKI-së; Aneks 2- dosja e Komisionit; Aneks 3 - Raportet e DSIK-së, Aneks 4 - dosja e komunikimit me subjektin, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca, dhe shpall këtë vendim në datën 17.07.2018, sipas nenit 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.



## VI. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR.

1. Referuar Aneksit të Kushtetutës, (neni D), ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues konkludon se për subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca, kanë rezultuar të vërtetuara:

- ✓ deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 (neni 33, pika 5/a, e ligjit);
- ✓ mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë në shumën prej 1.393.336 lekësh. (neni 33 pika 5/b e ligjit);
- ✓ fshehje pasurie, autoveturë me targa TR (neni 33, pika 5/c, e ligjit);
- ✓ deklarime të pasakta, mosdeklarime dhe mospërputhje deklarimesh, në deklaratat periodike, në kundërshtim me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndyshuar;
- ✓ Deklarim të rremë lidhur me çmimin e blerjes së garazhit (neni 33 pika 5/ç e ligjit).
- ✓ Deklarim i rremë, i bashkëshortes dhe fëmijëve në autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, në pjesën “*nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim*”, (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit).

2. Referuar Aneksit të Kushtetutës, (neni DH), ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, trupi gjykues konkludon se për subjektin e rivlerësimit z. Tom Ndreca, ka rezultuar pasaktësi gjatë plotësimit të formularit për pastërtinë e figurës.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- ➔ Ka deklarime të pamjafueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë (neni 61/3 i ligjit)
- ➔ Ka pasaktësi në plotësimin e formularit për pastërtinë e figurës (neni 61/5 i ligjit)

dhe atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### PËR KËTO ARSYE

Komisioni, bazuar në nenin 61 pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit D e DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. Tom Ndreca, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelit nga subjektet e interesuara, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë më 17.07.2018.

**TRUPI GJYKUES****Kryesuese****Relatore****Anëtar****Brunilda Bekteshi****Firdes Shuli****Roland Ilia****Sekretare gjyqësore****Ina Serjanaj**